



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18 qershor 2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Raportimi i ministres së Drejtësisë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit gjatë vitit 2017.
2. Shqyrtimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.
(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço Silva Caka, Elena Xhina, Luciano Boci.

Mungojnë:

Tom Doshi.

Të ftuar:

Etilda Saliu- Ministre e Drejtësisë

Jonida Gaba- Drejtore e Kabinetit në Ministrinë e Drejtësisë

Edlira Bako- Drejtore e Drejtorisë Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

Periand Teta- Drejtor i Hartimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Kourumi është i pranishëm, prandaj do të vazhdojmë me rendin e ditës.

Sot kemi dy pika në rendin e ditës. Pika e parë është raportimi i ministres së Drejtësisë për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2017.

Pika e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669 datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar””, për të cilën jemi komision përgjegjës dhe relatore është zonja Hysi, por këtë pikë të rendit të ditës, për shkak të një angazhimi të relatores, do ta shtyjmë për mbledhjen e ardhshme, kështu që sot mbetemi vetëm te pika e parë e rendit të ditës.

Ka konfirmuar pjesëmarrjen zonja Etilda Saliu, ministre e Drejtësisë.

Mirë se keni ardhur zonja Ministre!

Gjithashtu, stafi që e shoqëron është i përbërë nga zonja Jonida Gabi, drejtore e Kabinetit, zonja Edlira Bako, drejtore e drejtorisë Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë dhe zoti Periand Teta, drejtor i Hartimit të Legjislacionit.

Ju lutem, mbani qetësi ta dëgjojmë njëri-tjetrin, pasi jemi shumë veta në këtë sallë.

Në fakt, raporti dhe rekomandimet prioritare të Ministrisë së Drejtësisë për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2017 u janë bërë të njohura kolegëve paraprakisht nëpërmjet postës elektronike.

Për opinionin publik dhe për mediet e pranishme do t’ia jap fjalën ministres së Drejtësisë për të bërë një prezantim të shkurtër të rekomandimeve.

Për procedurë e ka kërkuar fjalën zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Kur e kërkoj fjalën për procedurë, nuk duhet të keni asnjë lloj droje për të ma dhënë, sepse bëhet fjalë për mbarëvajtjen e punimeve të komisionit dhe për ta vendosur në hulli aktin e sotëm.

Përfaqësuesit e qeverisë kanë ardhur sot për të diskutuar, për të raportuar në parlament lidhur me luftën ndaj kriminalitetit.

Kjo është çështje e madhe, apo jo? Unë mendoj se është rëndësishme. Shumë mirë që ka ardhur përfaqësuesi i qeverisë të përballet me parlamentin, me deputetët, me përfaqësuesit e

popullit, sigurisht, jo si pelegrinazhi që po bën Kryeministri andej-këndeje me njerëz të zgjedhur për bashkëqeverisjen me publikun. Ky është një akt, i cili duhet vlerësuar, sepse është i rëndësishëm jo vetëm për mënyrën si duhet të zhvillohet seanca e sotme, por edhe për një gjë tjetër më të madhe se kaq, jemi një javë larg nga momenti historik, të cilin e kemi përmendur sa herë që e kemi marrë fjalën për procedurë këtë muaj, nga momenti kur Europa do të japë notën e vlerësimit për shqiptarët, çeljen e negociatave. Kjo notë vlerësimi ka të bëjë, mbi të gjitha, me luftën ndaj kriminalitetit, pra sa institucionet ligjzbatuese të këtij vendi e kanë luftuar kriminalitetin ose e kanë mbështetur atë, sa është vullneti i qeverisë për ta luftuar në mënyrë serioze atë.

Në fakt, për t'i qëndruar strikt Rregullores së parlamentit, as nga ju, zoti kryetar, as nga sekretaria e komisionit nuk na është dhënë deri tani ne, deputetëve të opozitës, por, me çfarë shoh, as deputetëve të maxhorancës një raport i shkruar, i përgatitur nga institucioni, i cili ka ardhur për të raportuar. Ju kujtoj që Rregullorja e parlamentit, tradita e tij, është më se e qartë për çdo institucion, i cili vjen të deklarojë dhe të raportojë para Kuvendit. Paraprakisht depoziton raportin e shkruar, në këtë rast, në mënyrë që deputetët të njihen dhe të jenë në gjendje për të debatuar në mënyrë serioze për atë ç'ka dëshirë të thotë qeveria para Kuvendit.

Neni 103 i Rregullores e përcakton qartë: “Institucionet që vijnë deklarojnë para Kuvendi të Republikës së Shqipërisë, e depozitojnë raportin, e krahasojnë atë me raportet e institucioneve të tjera homologe...”. Në këtë rast, dua të përmend faktin që raportimi i Ministrisë së Drejtësisë duhet të konfrontohet edhe me raportin e Prokurorisë së Përgjithshme, përderisa bëhet fjalë pikërisht për faktin se sa janë zbatuar rekomandimet e dhëna nga qeveria në fillim të vitit 2017. Në krye të këtij viti ka dy institucione të tjera, të cilat duhet të raportojnë. Njëra është Prokuroria e Përgjithshme dhe tjetra është Ministria e Drejtësisë. Nuk ka një raport të shkruar.

Në fakt, e kuptoj historinë, po e quaj edhe frikë për të raportuar dhe për të lënë gjëra me shkrim nga institucionet më të larta, sepse, të paktën, edhe funksionari që ka ardhur sot para Komisionit të Ligjeve, media është vënë në dijeni, mund të flasë për çdo gjë, por nuk mund të flasë për çështjen e Tahirit; për çdo gjë tjetër mund të flasë, por jo për atë të Fatmir dhe Agron Xhafajt; për çdo gjë mund të flasë, por jo për atë të Nezar Seitaj, për ca arsye të tjera. Pyetja është: pse ka ardhur sot të flasë, nëse nuk pranon të flasë pikërisht për këto çështje? Për koleksionin pranverë-verë të “Miu-Miu”-t, do të flasim sot?

Këto janë gjërat më të rëndësishme, të cilat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E paragjykoj, sepse asnjëri prej jush nuk duhet të pranojë faktin që ai ka ardhur pa një dokument të shkruar!

Gjithsesi, meqë ka ardhur, mendoj se ka shumë gjëra për të thënë, sidomos nga Ministria e Drejtësisë. Sot që flasim, mbi këtë ministri dhe mbi titullarin e saj, qëndron një faturë shumë e rëndë, qoftë në kuadër të çeljes së negociatave, të kushteve, parakushteve, të suksesit apo të dështimit të reformës në drejtësi, të luftës ndaj kriminalitetit, qoftë edhe për një fakt tjetër akoma më të rëndë. Sot, Republika jonë, që për 7 ditë kërkon të çelë negociatat, është një republikë, së cilës i ka rënë njëra këmbë e pushtetit, sistemi i drejtësisë. Kjo, shpresoj dhe duhet të jetë një nga sensibilitetet dhe merakët më të mëdha që duhet të ketë Ministria e Drejtësisë. Sot Republika e Shqipërisë është pa Gjykatë Kushtetuese.

Ulsi Manja - Më falni, zoti Alibeaj!

Duhet ta mbyllni, se e morët fjalën për procedurë nëse doni të flasë edhe ministrja e Drejtësisë, në të kundërtën e mbyllim mbledhjen.

Enkelejd Alibeaj – Jo, vetëm mbledhjen mos e mbyllni!

Vetëm frika e fjalës duhet të jetë!

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja - Në qoftë se doni përgjigje nga Ministria e Drejtësisë, mund ta përmbyllni fjalën që t’i jepni mundësinë të flasë ministres!

Enkelejd Alibeaj – Mos më ndërprisni!

Meraku kryesor që duhet të ketë sot Ministria e Drejtësisë, bashkë me të edhe qeveria, është fakti që kjo republikë prezantohet sot në Europë pa Gjykatë Kushtetuese, së pari, e bashkë me të, edhe pa Kushtetutë; bashkë me të edhe pa garancitë kryesore që u ofrohen individëve për të gjetur drejtësi në këtë vend,

ku drejtësia është bërë malli më i rrallë.

Sot do të duhet të flas për faktin tjetër, që Gjykata e Lartë është në kolaps total, 28 mijë çështje...

Ulsi Manja - Të lutem, për procedurë, cili është propozimi konkret, se nuk kam kohë për të humbur gjithë ditën me ty, e kam sinqerisht! Ministrja e Drejtësisë ka ardhur për të raportuar para deputetëve dhe opinionit publik. Cili është propozimi konkret për procedurë?

Enkelejd Alibeaj – E ke bërë ti këtë? Kush je ti që nuk humbet kohë me ne?

Ulsi Manja – Të lutem, kam thirrur Ministren e Drejtësisë për të sqaruar opinionin publik për vitin 2017...

Enkelejd Alibeaj – Duam kohë të plotë për të folur pikërisht për çështjen...

Ulsi Manja – A ka mundësi të na thuash propozimin konkret?

Enkelejd Alibeaj – Ti do të presësh...

Ulsi Manja – Jo, nuk të pres ty unë...

Enkelejd Alibeaj – Të bëj parashtrimin unë...

Ulsi Manja – Për procedurë janë 2 minuta...

Enkelejd Alibeaj – Nuk mund të më japësh fjalën për 2 minuta...

Ulsi Manja – Unë e kam shumë të lehtë unë...

Enkelejd Alibeaj – Të ikësh, t'ia mbathësh?

Ulsi Manja - E mbyll mbledhjen e komisionit dhe ti vazhdo bëj konferencë shtypi në sallën e Komisionit të Ligjeve...

Enkelejd Alibeaj – Ju jeni mësuar t'ia mbathni...

Ulsi Manja – Jo, çfarë të mbathure...

Enkelejd Alibeaj – Nuk qeveriset vendi me të mbathur...

Ulsi Manja - Ne nuk ikim prej jush, problemi qëndron te propozimi konkret për procedurë...

Enkelejd Alibeaj – Vëre mbledhjen e komisionit në ulli duke u përballur me procedurën...

Ulsi Manja – Në bazë të Rregullores së Kuvendit...

Enkelejd Alibeaj - ... mundësisht duke gjetur edhe zgjidhje...

Ulsi Manja – Propozimin konkret?

Enkelejd Alibeaj - .. për problemet kryesore...

Ulsi Manja – Si kërkoni të vazhdojmë me procedurën konkrete?

Enkelejd Alibeaj – Si fillim ki durim të mos ia mbathësh dhe më dëgjo...

Ulsi Manja – Unë nuk jam nga ata burra që ia mbathin...

Enkelejd Alibeaj - Ky është problemi kryesor i sotëm për të cilin duhet të flasin përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Gjykata e Lartë e kapur. Gjykata e Lartë në kolaps. Sot 25 mijë familje shqiptare me halle nuk gjejnë drejtësi. Problemi kryesor i sotëm është lufta... Doni të flas sot për kriminalitetin? Po a ka gjë më të madhe sot të flasësh për kriminalitetin, sepse kryefjala është që organi që duhet ta luftojë kriminalitetin, kryesisht prokuroria, sot drejtohet nga një njeri i

emëruar në mënyrë politike, qartësisht në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjin dhe pa veting. Kapje e qartë e drejtësisë.

Çfarë do t'u tregoni sot ju shqiptarëve për luftën ndaj kriminalitetit? Ku është interesi publik këtu? Kapja e drejtësisë, kapja e prokurorisë, kapja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda apo me historinë e mosngritjes ndonjëherë, as në horizont nuk duken, të organeve të reja të institucioneve të drejtësisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë apo Këshilli i Lartë Gjyqësor. Apo dështimi i madh që po i bëni me dashje njërit prej organeve të reja të drejtësisë siç është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për ta futur në kolaps total Republikën, jo sistemin e drejtësisë. Ja pra këto janë çështje për të cilat unë besoj se duhej të flisnim...

Ulsi Manja – Patjetër!

Enkelejd Alibeaj – Po duhej të ishte e shkruar ajo, prandaj do të bëhej edhe kërkesa për procedurë...

Kjo do të thotë se historia e kapjes së drejtësisë, e rrëmbimit të drejtësisë, ka sjellë sot, të gjitha janë në sytë e publikut, frytet e hidhura për të gjithë shqiptarët, për ata, të cilët aspirojnë ende për çeljen e negociatave dhe që duan vërtet çeljen e negociatave. Ku është sot Saimir Tahiri, me prokurorinë e re që duhej të luftonte kriminalitetin...

Ulsi Manja – Të lutem, zoti Alibeaj, e morët fjalën për procedurë! A keni propozim konkret?

Enkelejd Alibeaj – Ku është sot Fatmir Xhafaj?

Ulsi Manja - A ka propozim konkret për procedurë?

Enkelejd Alibeaj – Vazhdon dhe pretendon të luftojë kriminalitetin...

Ulsi Manja – Të lutem!

Enkelejd Alibeaj - ... ndërkohë që i vëllai i tij...

Ulsi Manja – Unë e kuptoj që kemi mediet, të cilat po e transmetojnë mbledhjen live dhe ty të ka marrë malli të flasësh dhe të dalësh në televizor, por këtu jemi për punë...

Enkelejd Alibeaj – Kjo është puna...

Ulsi Manja – Punë është kjo që ke ardhur këtu dhe kërkon të marrësh mediet peng dhe komisionin...

A keni propozim konkret për procedurë?

Enkelejd Alibeaj – Ja, jua them unë tani...

Ulsi Manja – Cili është propozimi, ma thoni?

Enkelejd Alibeaj – Do t’jua them unë atëherë kur duhet, dëgjoni një herë parashtresën, ta dëgjoj edhe ministrja e Drejtësisë se e ka detyrim nga rregullorja.

Sot shqiptarët duan të dinë si ka mundësi...

Ulsi Manja – Zonja Ministre, zoti Alibeaj...

Enkelejd Alibeaj - ... që Agron Xhafaj.

Një minutë, e kam unë fjalën!

Ulsi Manja – Po çfarë fjale...

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Ministre!

(Diskutime pa mikrofon)

Për procedurë fjala është 2 minuta.

(Diskutime pa mikrofon)

A e lexon Rregulloren e Kuvendit ti apo jo?

Ti lexon rregulloren e Saliut dhe ky nuk është faji im...

(Diskutime pa mikrofon)

Rregullorja e Kuvendit e ka 2 minuta për procedurë...

Enkelejd Alibeaj – Është puna jote, si kryetar i Komisionit të Ligjeve të respektosh të drejtat...

Ulsi Manja – Ai do të flasë dhe kur të vijë ndeshja në orën 14:00... A e kuptoni?

Ju e keni hallin te sporti, keni hallin të kapni kohën, ta shtyni kohën në komision në kuptimin që kur të ikni të shihni sportin...

(Diskutime pa mikrofon)

Për ju Shqipëria kampionat botëror është, sport. A e kuptoni apo jo?

Ju lutem, a ka mundësi ta mbyllni fjalën për procedurë...

Enkelejd Alibeaj – Më lini të flas...

Ulsi Manja – Po çfarë të flisni, keni 1 orë që e keni marrë fjalën.

Ju lutem, përmbyllen fjalën!

(Diskutime pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Do të flasim të gjithë deputetët...

Ulsi Manja – Do të flisni, por do të flisni te selia e PD-së më mbrapa...

Enkelejd Alibeaj – Kur kjo të bëhet selia jote, atëherë do të flasësh ti, atëherë vendosi rregullat...

(Dërrhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po folët për rendin e ditës, merreni fjalën të gjithë me radhë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Nëse ti i ke nxjerr tapinë edhe kësaj, atëherë ke të drejtë të flasësh. Nuk je ti pronari këtu. Askush këtu nuk është pronar. Pronarë janë qytetarët shqiptarë. Ata duan të dëgjojnë. Ty të vjen zor, të vjen hidhur, kjo është puna jote!

Ulsi Manja – Përmbylle, se the për procedurë!

Enkelejd Alibeaj – Ja pra, kjo është ajo çfarë duan te dëgjojnë sot shqiptarët, se çfarë bëhet sot me Agron Xhafajn. Si ka mundësi të barisë i lirë në Vlorë, në Shqipëri, madje edhe para Ministrisë së Drejtësisë, i dënuar me 7 vjet e dy muaj dhe të ketë zero reagim në emër të luftës ndaj kriminalitetit?! Ja pra, kjo është ajo çfarë duhet të raportohet me seriozitet.

Ore, ju duhet të kuptoni një gjë: ju vërtet mund ta keni marrë si shfaqje këtë histori, me këtë pelegrinazhin, ku dilni andej-këndej dhe sfidoni shqiptarët me inteligjencën e tyre...

Ulsi Manja – Ç’punë keni ju me pelegrinazhin tonë?! Dilni edhe ju! Nuk ju mban kush! Dilni! Mos rrini sa te selia e PD-së, sa në komisione këtu. Dilni! Kush ju mban?!

Enkelejd Alibeaj – Ulsi, kjo është një gjë që ti nuk e mban dot mbi supe.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ç’rëndësi ka se me kë mblidhemi ne?! Dilni dhe mblidhuni edhe ju!

Enkelejd Alibeaj – Ju mblidhuni me kë të doni. Se me kë mblidhuni ju, kjo është e qartë.

Ulsi Manja – Dilni, mos rrini në Tiranë!

Enkelejd Alibeaj – Mblidhu me Saimirin, mblidhu me Fatmirin, mblidhu me Agronin, mblidhu me... Kjo është shoqëria juaj.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Qefalia...

Enkelejd Alibeaj – Në qoftë se ju keni...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – E ka kërkuar fjalën zoti Qefalia për procedurë.

Enkelejd Alibeaj – Një minutë, të mbaroj unë njëherë!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Do të flasë Xhemali, do të flasin të gjithë...

Pa merak!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndeshja e vetme, për të cilën shqiptarët duan të dëgjojnë sot, madje duan të marrin vesh edhe rezultatin, është pikërisht kjo. Dhe që rezultati i kësaj ndeshjeje të të gjithë shqiptarëve të jetë pozitiv, këtë po ju kërkojmë: seriozitet. Dhe si është serioziteti? Pikërisht, ai seriozitet është...

Ulsi Manja – Ndeshja fitohet me punë, jo me llafe.

Enkelejd Alibeaj – Ndonjëherë edhe fitohet. E keni provuar ju këtë. E ka provuar edhe ai këtë historinë e parave të drogës. Dakord? Ashtu fitohet.

Ajo çfarë shqiptarët duan të fitojnë, është pikërisht kjo gjë sot...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Nuk ka procedurë. Mbaron një këtëj, një këtëj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj - E ka detyrimin zonja...

Çfarë ndodh sot? Pse ka totalisht shkelje të ligjeve të Kodit të Procedurës Penale, gjithmonë, në emër të luftës ndaj kriminalitetit, me Agron Xhafajn?

Çfarë ndodh sot me historinë e aplikimit të ligjit antimafia?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – A do të raportojë ajo tani? T'ia japim mundësinë të raportojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Meqë ra llafi, zonja është edhe koordinatore kombëtare antikorrupsion dhe duhet të flasë edhe për aplikimin e ligjit antimafia...

Ulsi Manja – Nuk ia kemi dhënë fjalën akoma.

Enkelejd Alibeaj - ...ndaj ministrit të Brendshëm dhe vëllait të ministrit të Brendshëm.

Ulsi Manja – Po t'ia japim fjalën, pra!

Po, zoti Fino.

Enkelejd Alibeaj – Një minutë, se nuk kam mbaruar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Respekto Rregulloren edhe për Finon!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Patjetër, patjetër!

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, krijojani mundësinë zotit Fino të ulet, sepse është anëtar i Komisionit të Ligjeve dhe do të...!

Ju lutem, mund të vazhdoni atje...!

Zoti Luka, krijojini mundësinë të ulet te vendi i vet.

Silli një karrige tjetër.

Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – E zuri vendin Fino?

Ulsi Manja – Të lutem, zoti Alibeaj! Mund ta përmbyllni fjalën për procedurë, nëse doni t'ia japim fjalën ministres, që të marrin përgjigje pyetjet tuaja.

Enkelejd Alibeaj – Në minutë, se nuk i bëra pyetjet. Mos e shit si histori pyetjesh.

Ka një detyrim procedural të Rregullores...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, pra po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – I pari që duhet ta zbatojë jeni ju, si kryetar komisioni.

Ulsi Manja – Me Rregulloren jam në rregull.

Enkelejd Alibeaj –Së dyti, sipas Rregullores, edhe anëtarët e Komisionit të Ligjeve, të gjithë deputetët, pa dallim, maxhorancë dhe opozitë, duhet ta kenë materialin të shkruar...

Ulsi Manja – Cili është propozimi juaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Të përgatitet. Qeveria të përgatitet për çështjet më të rëndësishme që shqiptarët kërkojnë sot...

Ulsi Manja – Ju kërkoni të keni në dispozicion raportin?

Enkelejd Alibeaj – Sigurisht.

Ulsi Manja – Ky është propozimi?

Ja, ta marrim propozimin tuaj për procedurë...

Enkelejd Alibeaj - ... Kjo është gjëja më e rëndësishme, sepse nuk është thjesht dhe vetëm ta shkruajmë. Ajo që ne po u themi, besoj edhe shqiptarët duan t'ua thonë, kur këta të kenë guximin të dalin para shqiptarëve, jo para pelegrinazheve pasat që bëjnë, janë pikërisht këto çështje, nga të cilat varet kontrolli i qeverisë dhe kontrolli që duhet t'i bëjë parlamentit.

Ulsi Manja – Dakord.

Enkelejd Alibeaj – Duhet të përgatiteni një orë e më parë për ta vendosur këtë parlament në kushtet më minimale për të debatuar për çështjet më të rëndësishme, çeljen e negociatave dhe luftës ndaj kriminalitetit. Duhet guxim i madh të përgatitesh, sepse nuk ke nga shkon, nuk ke nga lëviz, pasi duhet t’u japësh përgjigje pyetjeve për Fatmir Xhafajn, për Agron Xhafajn, për Saimir Tahirin, për Rezart Seitin, për Air Albania dhe për Teatrin Kombëtar. Këto çështje kanë lidhje me kriminalitetin, sepse në këtë vend ka dy shtylla: kriminalitet dhe drogë, para të pista dhe vjedhja e pronës së shqiptarëve. Kjo është historia.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Ka pasur një kërkesë nga zoti Alibeaj, që deputetët të kenë në dispozicion një material me shkrim nga Ministria e Drejtësisë. Materiali që keni përpara ka të bëjë me rekomandimet prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2017.

Oerd Bylykbashi – Për procedurë.

Ulsi Manja - Ju lutem, të mbaroj unë!

Sigurisht, me reformën e re në drejtësi dhe me kompetencat që ka sot Ministria e Drejtësisë, edhe natyra e raportimit të Ministrisë së Drejtësisë nuk është ajo që ka qenë. Sfera e përgjithësisë që ka sot Ministria e Drejtësisë dihet, por gjithsesi ajo sot ka ardhur këtu në cilësinë e përfaqësueses së ekzekutivit për zbatimin e rekomandimeve që qeveria jep në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2017.

Oerd Bylykbashi – Kryetar, për procedurë.

Ulsi Manja - Ju lutem!

E dyta, ka një propozim për procedurë, që të kemi një raport analitik me shkrim nga Ministria e Drejtësisë për kolegët deputetë. Më duket kërkesë racionale, ndaj edhe unë bashkohem me propozimin e kolegut Alibeaj.

Oerd Bylykbashi – Një sekondë, Ulsi!

Ulsi Manja - Zonja Ministre, unë ju falënderoj për prezencën tuaj sot në Komisionin e Ligjeve për të raportuar për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2017, rekomandimet e qeverisë për vitin 2017, por gjithsesi, meqenëse kolegët e opozitës kërkojnë një raport të detajuar për punën e Ministrisë së Drejtësisë brenda sferave kushtetuese dhe ligjore, unë pse jo, po ua krijoj këtë mundësi jo vetëm deputetëve të opozitës, por edhe kolegëve të mi të maxhorancës, që ta kenë përpara këtë material.

Ju falënderoj për prezencën sot në komision!

Oerd Bylykbashi – Për procedurë.

Ulsi Manja - Këtu e konsideroj të mbyllur mbledhjen e komisionit për ditën e sotme!

Faleminderit!

Ditë të mbarë dhe suksese për kampionatin botëror!

Oerd Bylykbashi – Ulsi, ministrja të ka vënë rekomandim prioritar rritjen e bashkëpunimit me Inspektoratin e Pyjeve dhe rritjen e bashkëpunimit me Policinë Ushtarake. Këto të dyja ka ajo prioritet deri më sot, ndërkohë, që të japë llogari për historitë e ...

MBYLLET MBLEDHJA